

URDHËR
Nr. 169, datë 31.7.2024

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe në zbatim të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 21, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; si dhe të nenit 30, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, për shkak të lejes vjetore të Kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së përfaqësimit të institucionit në marrëdhëniet me palët e treta, znj. Alba Qirjazi, Sekretare e Përgjithshme e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
 2. Delegimin e kompetencës së mësipërme për periudhën nga data 5.8.2024 deri në datën 23.8.2024.
 3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, znj. Alba Qirjazi.
 4. Znj. Alba Qirjazi nuk mund ta nëndelegojë këtë kompetencë.
 5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIT
Sokol Çomo